REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
Nr.Prot: 388/13 Data: 15.01.2013
Br. Prot: Datum:
Prot. No.: Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 388/13
Datë 15.01.2013

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 15.12.2012 nxjerr këtë:

VENDIM

Për akreditimin e Qendrës Rajonale për Aftësim Profesional, Prizren, për periudhën: 15/12/2012 - 31/07/2015 për këtë/o kualifikime të aprovuara:

1.1. Teknologji Informative dhe e komunikimit - (niveli i KKK-së II)

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Në hyrje të objektit të QRAP - Prizren nuk ka ndonjë hapësirë pritëse për kandidatët, por ka shenja orientuese në katin e parë, por këto shenja nuk janë kaq dalluese edhe në katin e dytë. Rekomandohet që edhe në katin e dytë të bëhet shënjimi i saktë.
- Salla e trajnimit është e pajisur me 16 kompjuter, 1 kompjuter për nevoja të trajnerit/instruktorit, dhe 1 tabelë pune. Salla nuk posedon projektor apo panel të projektimit që do ta bënte sa me atraktiv ligjërimin e po ashtu do të lehtësonte punën trajnerit. Rekomandohet që salla e trajnimeve të pajiset me projektor apo panel projektimi

- Nga informacionet në ditën e vizitës u informuam që kompjuterët që përdoren për nevoja të trajnimit, sistemin operativ (Windows XP) e kanë të licencuar meqë i kanë marrë nga Qeveria e Kosovës, por që nuk është vërtetuar nga ana jonë e as që kemi marrë dëshmi për një licencim të tillë. E njëjta vlen edhe për programin aplikativ MS Office 2003 që përdoret nga ana e qendrës.
- QRAP në ekzistencën e saj për rreth gjysmë shekulli ka trajnuar dhe vazhdon të trajnojë një numër të konsiderueshëm të kandidatëve dhe nuk ekziston ndonjë bazë e të dhënave e mirëfilltë. Zakonisht punohet me lista të Excelit por që nuk janë të centralizuara. Rekomandohet që të krijohet një bazë e të dhënave që do të mundësonte ruajtjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave të kandidatëve në mënyrë shumë më të mirë dhe efikase.
- Edhe përkundër faktit që kandidatit i ofrohet edukimi profesional në fushën e teknologjisë informative ashtu që ai/ajo të shtojë mundësitë e gjetjes së punës dhe fakti që në masë të caktuar QRAP bashkëpunon me sektorin privat për të ndihmuar sado pak kandidatin që të punësohet, serish zinxhiri i komunikimit shkëputet në momentin që kandidati largohet nga qendra. Rekomandohet që të shtohet ky komunikim me qellim të marrjes se informatave kthyese dhe të vazhdohet kontakti me kandidatin deri në akomodimin e plotë të tij/saj.
- Kandidatët janë në nivele të ndryshme dhe është paksa e papërshtatshme që trajneri në të njëjtën orë të merret me grupe të ndryshme të kandidatëve, ku një kandidat është në modulin e parë, një tjetër në të tretin e kështu me radhë. Rekomandohet që nëse është e mundur grupi të jetë sa ma homogjen duke krijuar grupe që janë në modulin e njëjtë.
- Me gjithë përkushtimin e madh të stafit menaxhues, administrativ, instruktoreve dhe të kandidateve, kurrikuli është paksa i vjetër, prandaj rekomandohet që ky kurrikul të përditësohet apo edhe të kalohet komplet në standardin ECDL, meqenëse modulet janë të ngjashme me këtë standard.
- QRAP nuk posedon: intranet e as ueb sajt te vetin. Rekomandohet që të kenë një hapësirë në kuadër të faqes së MPMS dhe të mund të administrojnë vetë, ose edhe të kenë një faqe të përbashkët për të gjitha qendrat.
- Meqë QRAP është një vatër e mirëfilltë edukative ku merren njohuri profesionale, kandidatët nuk dallohen nga nëpunësit e organizatës. Kjo vë në pah faktin që medoemos duhet të vendoset një standard në identifikimin e nëpunësve nga kandidatët dhe të tjerët.
- Komunikimi i zyrtarëve të qendrës me organizata dhe persona të ndryshëm realizohet përmes postes elektronike private. Rekomandohet që stafi menaxhues dhe të tjerët të pajisen me e-poste zyrtar dhe komunikimi zyrtar të kryhet përmes e-postave zyrtare.
- Literatura e përdorur nga kandidatët në ambientet e qendrës nuk mund të përdoret edhe në shtëpi. Nëse kandidatët dëshirojnë ta marrin literaturën duhet ta fotokopjojnë me mjetet e veta financiare dhe kur kihet parasysh se kandidatët janë punëkërkues, kjo është një barrë e rëndë. Rekomandohet që literatura të ju jepet në shfrytëzim gjatë kohës së trajnimit.
- Nëse kandidati nuk e kalon testin final, atëherë duhet të dëgjojë edhe njëherë trajnimin. Rekomandohet që ti jepet mundësia e ri testimit

- Kompjuterët nuk janë të pajisur me internet dhe si pasojë kandidatët nuk mund të praktikojnë modulin e internetit. Rekomandohet që të pajiset me internet se paku një kompjuter në mënyrë që kandidatët të mund të praktikojnë modulin e internetit.
- Disa kompjuterë janë tepër të vjetër dhe është rekomandim edhe i trajnerit edhe i panelit që të ndërrohen me kompjuterë të rinj.

  Afati përmbushjes se këtyre kushteve është: 01.01.2014

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë:15.12.2012, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

-Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet:

- QRAP, Prizren;
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi